



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

### Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës

Adresa: Rr. Shqipëria nr: 28, Lipjan, Republika e Kosovës

## 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

### Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit (KL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Lipjanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Lipjanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A1 Shpenzimet prej 62,634€ të dedikuara për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, janë përdorur për pagesën e obligimeve tjera në bazë të kontratave të nënshkruara;
- C1 Komuna ka zhvilluar procedura të prokurimit jashtë planit të prokurimit dhe pa njoftim paraprak të AQP-së.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Theksimi i Çështjes**

- 1 Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se Komuna kishte bërë pagesa nga kategoria e Mallrave dhe shërbimeve dhe Investimeve kapitale në bazë të Vendimeve gjyqësore në shumë prej 329,870€ për kompensimin e pagave jubilarë, pagave përcjellëse dhe shpenzimet tjera të procedurave gjyqësore.

Përveç kësaj, Komuna kishte bërë edhe pagesa tjera nga kategoria e Investimeve kapitale në shumë prej 41,887€ si rezultat i shpenzimit të gabuar, edhe pse këto pagesa ishin të planifikuara tek kategoria adekuatë Mallra dhe shërbime.

Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuatë kanë rezultuar me mbivlerësimin e kategorisë Mallra e shërbime dhe Investime kapitale dhe nënvlerësimin e kategorisë Paga dhe mëditje dhe Mallra e Shërbime për të njëjtën shumë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, të cilat me rastin e ndarjeve buxhetore nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, detyrimet për paga në bazë të Vendimeve gjyqësore nuk ishin marrë parasysh si detyrime rrjedhëse gjatë vitit, dhe rrjedhimisht, nuk ishte ndarë asnjë fond kontigjent për kompensimin e tyre. Thesari kishte ekzekutuar pagesat nga fondet e ndara për kategoritë tjera.

Duke qenë se ky problem është mjaft i përhapur edhe te organizatat tjera, më hollësisht do të trajtohet te Raporti i auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Lipjanit.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Lipjanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Lipjanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Lipjanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Lipjanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur më poshtë në Grafikon 1) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

**Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike<sup>4</sup>**



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Shpenzime jo në pajtim me vendimet e Qeverisë

#### Gjetja

Në bazë të vendimit të Qeverisë nr.01/23 të datës 13.08.2020 dhe procedurave tjera të udhëhequra nga Ministria e Pushtetit Lokal, komunat e Kosovës janë mbështetur me 10 milionë euro për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Komunës së Lipjanit nga kjo shumë i janë ndarë mjete në vlerë 216,809€, e të cilat janë kërkuar të alokohen në programin 18163 Infrastrukturë Publike.

Dy nga mostrat e testuara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, pagesa në vlerë 50,000€ si dhe pagesa prej 12,634€, janë të paguara nga kategoria e mjeteve që ishin të dedikuara për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

Pagesa në vlerë 50,000€ e datës 11.12.2020, ka të bëjë me kontratën "Mirëmbajtja e infrastrukturës, rrugëve të asfaltuara dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit, kurse pagesa në vlerë 12,634€ e datës 26.11.2020 ka të bëjë me kontratën "Zhavorimi i rrugëve të kategorisë së katërt në Komunën e Lipjanit".

Si rezultat i ekzekutimit të një numri të madh të vendimeve gjyqësore nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, komuna ka pasur mungesë të mjeteve buxhetore për pagesën e obligimeve tjera në bazë të kontratave të nënshkruara. Për këtë arsye komuna ka bërë pagesat e këtyre shpenzimeve nga fondet e alokuara për pandemi.

#### Ndikimi

Kjo ka ndikuar në zvogëlimin e shumës së shpenzuar për qëllimin për të cilin janë alokuar këto mjete dhe gjithashtu raportim jo të saktë të të dhënave në pasqyrat financiare për shpenzimet sa i përket menaxhimit të pandemisë Covid-19.

#### Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe shpenzimet e Komunës janë bërë konform qëllimit për të cilin janë alokuar dhe vendimeve të Qeverisë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja C1 - Zhvillimi i procedurave të prokurimit jashtë planit të prokurimit dhe pa njoftim paraprak të AQP-së

#### Gjetja

Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Prokurimin Publik (me ndryshime dhe plotësime) Autoriteti Kontraktues (AK) duhet të bëjë planin e prokurimit, në të cilin identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që AK parasheh të prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Ndërsa sipas nenit 9, pika 6, e ligjit të njëjtë precizohet që nëse aktiviteti i prokurimit nuk është përfshirë në planifikimin final të prokurimit, duhet të njoftohet Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) të paktën 5 ditë para autorizimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Komuna e Lipjanit, në planifikimin final të prokurimit kishte përfshirë gjithsej 108 aktivitete të prokurimit për furnizime, punë dhe shërbime, të cilat janë prokuruar gjatë vitit fiskal 2020. Mirëpo raporti i kontratave të realizuara dëshmon se në vitin 2020 janë realizuar edhe 14 aktivitete të cilat nuk ishin përfshirë në planin final të prokurimit, prej tyre 8 aktivitete të prokurimit janë zhvilluar për Covid-19, kurse 6 të tjera lidhen me projekte kapitale, ku vlera e këtyre projekteve është 394,154€. Kjo tregon se në planin e prokurimit nuk janë përfshirë të gjitha nevojat për furnizime, punë dhe shërbime. Për më tepër, për aktivitetet e zhvilluara jashtë planit, nuk është dërguar në AQP një kopje e deklaratës përkatëse të nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve para inicimit të aktivitetit përkatës të prokurimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së stafit (reduktimi i stafit) e krijuar nga situata pandemike me Covid-19.

#### **Ndikimi**

Tenderimet jashtë planit të prokurimit dhe duke mos njoftuar AQP-në mund të ndikojnë me shpenzim jo efikas të buxhetit dhe gjithashtu pasqyrojnë mungesë të vlerësimit të nevojave dhe planifikim të dobët të kërkesave.

#### **Rekomandimi C1**

Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP konform kërkesave ligjore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë edhe komunalitë në vitin 2020 ishte 3,452,410€, prej tyre ishin shpenzuar 2,748,509€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyrë, furnizim me pajisje, furnizime mjekësore, shërbime kontraktuese tjera, shpenzime komunale, etj. Kemi testuar 16 mostra për teste substanciale në vlerë 659,154€ si dhe 16 mostra për teste të pajtueshmërisë.

#### Çështja A2 - Dobësi në procesin e prokurimit

##### Gjetja

Sipas kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit në kushtet për pjesëmarrje, kapaciteti teknik dhe profesional ishte që “Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për furnizime të ngjashme në vlerë prej 50,000€ në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë”, e i cili kriter duhej të plotësohet përmes dëshmisë “Një listë të kontratave të realizuara ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve”.

Në procedurën e prokurimit “Blerja e inventarit për SHFMU Haradin Bajrami -Magure, SHFMU Drita -Rubofc dhe QEAP Qerdhe”, në dosjen e Operatorit Ekonomik (OE) fitues, ekzistonin vetëm “lista e kontratave” dhe “lista e referencave” për furnizimet e ngjashme të realizuara, por këtyre listave nuk ju kanë bashkëngjitur edhe referencat përkatëse ose procesverbalet e kryerjes së furnizimeve bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit, dhe të cilat nuk janë kërkuar gjatë vlerësimit. Vlera e kontratës së furnizimeve të dhëna është 32,384€.

Sipas zyrtarëve komunal, kjo ka ndodhur për shkak të ngarkesave në zyrën e prokurimit si rezultat i stafit të reduktuar nga situata me pandemi Covid-19.

##### Ndikimi

Mos-përfillja e kërkesave të dosjes së tenderit është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe mund të rezultojë me përzgjedhje të ofertuesve të pa përgjegjshëm duke shkelur parimin e trajtimit të barabartë të tenderuesve.

##### Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit nga komisionet e vlerësimit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet, të shpërblehen me kontratë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 628,025€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 592,738€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionet për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, për kulturë rini dhe sport, shëndetësi dhe përkujdesje sociale, për komunitete etj. Kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë 62,542€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

### Çështja A3 - Mungesa e dëshmive për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit

#### Gjetja

Sipas Kontratës me përfituesin e subvencionit, neni 3.2 lidhur me obligimet e përfituesit, saktëson që Përfituesi duhet të raportoj tek Komuna e Lipjanit përkatësisht te Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport duke sjellur dokumentacionin sipas projektit të paraqitur në formularët e aplikacionit si vijon: raport narrativ, raportin financiar për mjete e shpenzuara dhe kopjen e faturave.

Përfituesi i subvencionit KF "Arbëria" Dobrajë e Madhe në vlerë prej (19,970€) dhe KF "Ulpiana" në Lipjan 15,000€, kishin sjellur raportet brenda afatit ligjor, por kishte mungesë të dëshmive/faturave për shpenzimet e raportuara. Te përfituesi i parë, vlera prej 5,545€ nuk është e mbuluar me fatura, ndërsa te përfituesi i dytë, mungonin faturat për vlerën e paguar prej 6,834€.

Sqarimet nga komuna janë se zyrtari përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratave të klubeve sportive përfituese të subvencioneve për vitin 2020, për arsye mjekësore, nuk ka qenë në nivelin e kryerjes së detyrës.

#### Ndikimi

Mungesa e kontrolleve në monitorimin dhe raportimin për projektet e financuara nga komuna, ndikon në shpenzimin e mjeteve për qëllime tjera që nuk janë të paraqitura me kontratë dhe ekspozimin e pa rregullive të shpenzimit të fondeve publike.

#### Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, dhe nëse përfituesit e subvencionuar në raportimin e tyre nuk arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas kontratës, të zbatohen masat e përcaktuara me kontratë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B1 - Mungesa e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve

#### Gjetja

Bazuar në Rregulloren MF. NR. 04/2017, neni 6 - Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë Zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë ZKM dhe neni 26 - secili ofrues i mbështetjes financiare publike pasi të përgatis raportin vjetor, do t'i dërgojnë atë më së largu deri më 1 mars.

Komuna e Lipjanit edhe pse me Buxhet të Kosovës ka parapa që gjatë vitit 2020 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQ-ve, nuk e ka përmbushur kërkesën ligjore për të plotësuar formularin e Planit Vjetor të Mbështetjes Financiare si dhe Raportin Vjetor, për të dërguar në ZKM-ZQM.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të neglizhencës nga ana e zyrtarit përgjegjës të komunës për të mbështetur kërkesat ligjore.

#### **Ndikimi**

Aranzimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve që me kohë të parashikojnë të gjithë hapat që do të ndjekin në ofrimin e mbështetjes financiare publike, dhe me këtë rast të ndërmarrin të gjitha veprimet për ta implementuar thirrjen publike me sukses. Po ashtu do tu pamundësojnë OJQ-ve që të përgatiten për thirrjet publike.

#### **Rekomandimi B1**

Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr hapa në përmbushjen e kërkesave ligjore për vitet e ardhshme, të përgatitet Plani Vjetor për Mbështetjes Financiare 30 ditë pas miratimit të Buxhetit, Raporti Gjithëpërfshirës Vjetor i mbështetje financiare publike për OJQ, si dhe të dhënat që përfshihen në plan të korrespondojnë me Buxhetin e Miratuar.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.2.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,285,189€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 4,836,186€. Ato kanë të bëjnë me ndërtim të objekteve, ndërtimin e rrugëve lokale, trotuare, mirëmbajtje investive, hartim të objekteve etj. Kemi testuar 14 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 688,631€.

#### Çështja B2 - Siguria e ekzekutimit jovalide dhe vonesa në realizimin e punimeve

##### Gjetja

Në kontratat e nënshkruara për projektet kapitale ishin përcaktuar afatet kohore për realizimin e punimeve. Ndërsa me rregullat dhe udhëzuesin operativ për prokurimin publik, pika 30.6 specifikohet se, siguria e ekzekutimit mbetet valide për një periudhë tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës.

Kontrata e nënshkruar me 28.12.2020 në vlerë 73,192€ për "Rregullimin e Infrastrukturës (rrethojave, parkingjeve në shkolla)", ishte parapa që të përfundoj për 70 ditë kalendarike. Mirëpo për shkak kushteve atmosferike me kërkesën e menaxherit të kontratës punimet kanë filluar 55 ditë me vonesë. Siguria e ekzekutimit kishte validitet deri në mars të 2021 dhe si e tillë nuk ishte vazhduar deri në maj kur ne kemi audituar këtë kontratë.

Kontrata e nënshkruar në maj të vitit 2020 në vlerë prej 9,424€ për "Renovimin e banjove në shkollën "Shtjefen Gjeqovi në Janjevë" ishte parapa që të përfundoj për 20 ditë pune, mirëpo kishte vonesa në realizimin e punimeve për 23 ditë për shkak të gjendjes së krijuar me Covid-19.

Kjo ka ndodhur shkak i kontrollit dhe monitorimit jo të mirë për kontratat e nënshkruara në fund vit për projekte të paplanifikuara.

##### Ndikimi

Vonesat në realizimin e punimeve ndikojnë në mospërbushjen e obligimeve brenda afatit sipas planit dinamik dhe siguria e ekzekutimit jovalide, ofrojnë mundësinë për shpenzime shtesë të projekteve.

##### Rekomandimi B2

Kryetari duhet të siguroj se plani dinamik për përfundimin e punëve është respektuar nga OE, si dhe siguria e ekzekutimit do të mbetet valide për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës në mënyrë që t'i ikë rrezikut për shpenzimet shtesë në rast të vonesave në punë dhe dëmeve tjera.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.4 Të arkëtueshmet

Në PFV e vitit 2020 komuna ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 4,858,527€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë - parcelat, lejet afariste, qirat, tokat komunale, shpronësimi, shfrytëzimi i tregjeve dhe taksat.

### Çështja C2 - Menaxhimi i Llogarive të Arkëtueshme

#### Gjetja

Sipas "Ligjit nr. 06/L-005 neni 12 paragrafi 2, çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Po ashtu neni 3 i Rregullores komunale për taksat dhe tarifa e vitit 2008 ka definuar qarte çështjen e menaxhimit të taksave nga lejet e veprimtarive afariste.

Llogaritë e arkëtueshme janë shuma të faturuara e të pa arkëtuara për shërbimet të cilat i ofron komuna për klientët e saj. Pjesa më e madhe e borxheve janë nga tatimi pronë dhe lejet afariste.

Për kundër faktit se komuna ka marr masa lidhur me inkasimin e llogarive të arkëtueshme tek tatimi në pronë duke dërguar vërejtje dhe njoftimet përfundimtare tek tatimpaguesit, rritja e tyre vazhdon nga viti në vit. Kjo rritje ishte e ndikuar edhe nga borxhet e ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në vlerë prej 671,950€. Vlen të ceket që gjatë vitit 2020 është bërë bartja e pronave të komunës së Graçanicës në bazën e tatimit në pronë të kësaj komune, që deri në vitin 2019 figuronin në bazën e tatimit pronë të komunës së Lipjanit.

Po ashtu, borxhet nga lejet afariste janë mjaft të larta dhe të përcjellura që nga viti 2013 në vlerë 578,359€. Gjatë auditimit të 5 mostrave në vlerë totale prej 176,700€ nga kjo kategori, kemi hasur në përgjithësi në mungesë dëshmi, siç janë: aktvendimet për ngarkesat nëpër vite për bizneset, dëshmitë e pagesave. Në një rast është bërë borxhi nga një entitet në tjetrin në mënyrë të gabueshme. Si të tilla këto borxhe nuk pritet të arkëtohen, pasi që kanë kaluar mbi 7 vite nga pezullimi i taksave për lejet e operimit të bizneseve.

#### Ndikimi

Mungesa e veprimeve konkrete shpesh për arkëtimin e të arkëtueshmeve rezultojnë me rritje të këtyre llogarive, rrezikon që komuna të ketë humbje financiare si dhe rrezikon mos realizimin e projekteve të komunës të financuara nga të hyrat vetjake.

#### Rekomandimi C2

Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke intensifikuar bashkëpunimin me AKP-n lidhur me obligimet për NSH-të të cilat janë në menaxhimin e tyre, e po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga lejet afariste.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi                   | Buxheti fillestar    | Buxheti final <sup>5</sup> | 2020<br>Shpenzimet   | 2019<br>Shpenzimet   | 2018<br>Shpenzimet   |
|------------------------------|----------------------|----------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| <b>Burimet e fondeve</b>     | <b>18,005,722.00</b> | <b>19,970,018.05</b>       | <b>17,751,725.62</b> | <b>15,620,345.03</b> | <b>14,903,407.87</b> |
| Grante Qeveritare - Buxheti  | 15,924,803.00        | 16,289,499.31              | 15,498,440.78        | 13,294,779.44        | 13,352,789.05        |
| Financimi përmes huamarrjes  | 0.00                 | 158,196.40                 | 144,330.10           | 52,756.21            | 31,210.29            |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0.00                 | 980,932.30                 | 634,752.80           | 726,878.03           | 330,176.57           |
| Të hyrat vetanake            | 2,080,919.00         | 2,080,919.00               | 1,179,471.37         | 1,428,422.93         | 1,189,231.96         |
| Donacionet vendore           | 0.00                 | 13,807.56                  | 972.90               | 0.00                 | 0.00                 |
| Donacionet e jashtme         | 0.00                 | 446,663.48                 | 293,757.67           | 117,508.42           | 0.00                 |

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 1,964,296€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura 980,932€, donacionet e jashtme dhe të brendshme 460,471€, financimi nga huamarrja 158,196€ dhe rritja e grantit qeveritar prej 364,696€.


Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 89% të buxhetit përfundimtar ose 17,751,726€, me një ulje prej 3% në krahasim me vitin 2019. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**


| Përshkrimi                                             | Buxheti fillestar    | Buxheti final        | 2020<br>Shpenzimet   | 2019<br>Shpenzimet   | 2018<br>Shpenzimet   |
|--------------------------------------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| <b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b> | <b>18,005,722.00</b> | <b>19,970,018.05</b> | <b>17,751,725.62</b> | <b>15,620,345.03</b> | <b>14,903,407.87</b> |
| Pagat dhe mëditjet                                     | 9,300,160.00         | 9,604,394.72         | 9,574,291.63         | 9,096,501.84         | 9,036,804.04         |
| Mallrat dhe shërbimet                                  | 1,515,000.00         | 3,177,867.03         | 2,538,030.06         | 1,369,749.04         | 1,144,788.32         |
| Komunalitë                                             | 250,000.00           | 274,542.55           | 210,479.35           | 231,793.17           | 210,403.20           |
| Subvencionet dhe transferet                            | 350,000.00           | 628,024.50           | 592,738.14           | 400,221.20           | 336,750.12           |
| Investimet Kapitale                                    | 5,077,293.00         | 6,285,189.25         | 4,836,186.44         | 4,522,079.78         | 4,174,662.19         |
| Rezervat                                               | 1,513,269.00         | 0.00                 | 0.00                 | 0.00                 | 0.00                 |

## Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018 - 2020

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Përkundër një rritje të buxhetit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit, vetëm 77% e buxhetit ishte shpenzuar. Situata e krijuar me Covid -19, ka ndikuar që shpenzimet të përqendrohen më shumë në tremujorin e fundit me 60% të realizimit të buxhetit për Investime Kapitale. Programi i Investimeve Publike përfshin 94 projekte për vitin aktual. Të gjitha projektet nuk i përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, prandaj nga kategoria e Investimeve kapitale janë paguar paga me vendim gjykate për mësimdhënës, si dhe furnizime dhe shërbime që për nga natyra i takojnë kategorisë së Mallrave dhe Shërbimeve.

Rritja e buxhetit të Pagave dhe Mëditjeve për 304,235€ dhe Mallra e Shërbime me 1,662,867€ është për shkak të pandemisë, shtesat në paga për institucionet shëndetësore me vendim të qeverisë. Rritja në buxhetin e Mallrave dhe Shërbimeve përfshinë mjetet nga fondi rezervë, te hyrat e bartura, donacionet dhe mbështetjen financiare lidhur me menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia me vendim të qeverisë.

Buxheti për pandemi ishte 601,162€ (PM = 384,353 + MSH = 216,810€) mirëpo në 2020 ishin shpenzuar 888,973€. Vlera më e lartë e shpenzimeve për pandemi prej 287,811€ ishte e mbuluar nga kategoria e mallrave dhe Shërbimeve. Shpenzimet për pandemi kanë të bëjnë kryesisht me shtesat në paga (384,353€) për institucionet shëndetësore me vendim të qeverisë dhe mallra e shërbime (504,621€) për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia me vendim të qeverisë. Kemi testuar 8 mostra për paga në vlerë 3,800€ dhe 4 mostra për mallra dhe shërbime në vlerë 246,850€.

Të hyrat e realizuara gjatë vitit 2020 nga Komuna e Lipjanit ishin 1,550,680€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, etj. Po ashtu Komuna kishte edhe të hyra indirekte në vlerë prej 212,808€.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**


| Përshkrimi                | Buxheti fillestar   | Buxheti final       | 2020 Pranimet       | 2019 Pranimet       | 2018 Pranimet       |
|---------------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| <b>Totali i të hyrave</b> | <b>1,970,919.00</b> | <b>1,970,919.00</b> | <b>1,550,679.61</b> | <b>1,888,072.33</b> | <b>1,804,589.45</b> |
| Të hyrat tatimore         | 1,041,387.00        | 1,041,387.00        | 761,365.90          | 917,687.63          | 842,932.75          |
| Të hyrat jo tatimore      | 929,532.00          | 929,532.00          | 789,313.71          | 970,384.70          | 961,656.70          |

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunes së Lipjanit ka rezultuar në gjashtë (6) rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2020, dy (2) rekomandime janë zbatuar; dy (2) ishin në proces dhe dy (2) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 2. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 3.

**Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020**


| Nr | Fusha e Auditimit           | Rekomandimet e vitit 2019                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Veprimet e ndërmarra                                                                                                                                                                                                            | Statusi                    |
|----|-----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|
| 1. | Pasqyrat Financiare Vjetore | Kryetari duhet të siguroj se janë evidentuar dhe përlogaritur të gjitha rastet e stafit të pensionuar që pretendojnë kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse, në mënyrë që të planifikohet edhe buxheti për to. Po ashtu të gjitha obligimet duhet të paguhen me kohë dhe të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore, kamatë vonesa dhe shpenzime të përmbarimit. | Per vitin 2020 çështja ishte e njëjtë, megjithatë për vitin 2021 shpenzimet e tilla kanë filluar të ekzekutohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Çështja është e vendosur te theksimi i çështjes në raportin e vitit 2020. | Nuk është i aplikueshëm më |

|    |                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                      |                      |
|----|--------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| 2. | Pagat dhe mëditjet                   | Kryetari, deri në bartjen e buxhetit tek MPB-ja, duhet të kërkojë nga personat përgjegjës, që për zyrtarët të cilët paguhën nga buxheti i komunës të sigurohen së paku dosjet me informata bazike përfshirë kontratat e punës, si dhe raportet mujore për vijueshmërinë e tyre në punë, për t'u siguruar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim dhe që kanë ofruar shërbimet                               |                                                                                                                                                                                                                                      | I zbatuar            |
| 3. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Kryetari i komunës duhet të sigurohet që kontratat zbatohen sipas planit, dhe të aplikohen ndëshkimet në rastet e vonesave sipas kushteve të kontratës. Po ashtu Kryetari duhet të sigurojë funksionimin efikas të mekanizmave dhe kontrolleve financiare, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave.                                          |                                                                                                                                                                                                                                      | I zbatuar            |
| 4. | Subvencionet dhe transferet          | Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr hapa në përmbushjen e kërkesave ligjore për vitet e ardhshme, të përgatitet Plani Vjetor për Mbështetjes Financiare 30 ditë pas miratimit të Buxhetit, si dhe të dhënat që përfshihen në plan të korrespondojnë me Buxhetin e Miratuar.                                                                                                                         | Shih B1.                                                                                                                                                                                                                             | Nuk është adresuar   |
| 5. | Investimet kapitale                  | Kryetari duhet të sigurohet se asnjë dokumentacion i tenderit të mos lejohet pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit, i cili përcakton qartë natyrën dhe karakteristikat e performancës për punët e kërkuara, në mënyrë që të jetë i mundshëm realizimi i punëve sipas planit dinamik.                                                                                                      | Shih B2.                                                                                                                                                                                                                             | Nuk është adresuar   |
| 6. | Llogaritë e arkëtueshme              | Kryetari duhet të sigurojë veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në që çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit të tyre. Po ashtu të intensifikoj dhe të risë nivelin e koordinimit me Departamentin e tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave për bartjen e pronave që nuk i takojnë komunës. | Borxhet e ndërmarrjeve shoqërore që janë në proces të privatizimit nga AKP vazhdojnë të mbesin. Kurse pronat e komunës së Graçanicës, janë bartur nga komuna e Lipjanit në bazën e tatimit pronë të komunës së Graçanicës (shih C2). | Pjesërisht i zbatuar |

| Nr | Fusha e Auditimit   | Rekomandimet e vitit 2020                                                                                                                                                                       |
|----|---------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe shpenzimet e Komunës janë bërë konform qëllimit për të cilin janë alokuar dhe vendimeve të Qeverisë. |

|    |                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|----|--------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 2. | Baza për konkluzion                  | Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP konform kërkesave ligjore.                 |
| 3. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit nga komisionet e vlerësimit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet, të shpërblehen me kontratë.                                                                                                                  |
| 4. | Subvencionet dhe transferet          | Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, dhe nëse përfituesit e subvencionuar në raportimin e tyre nuk arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas kontratës, të zbatohen masat e përcaktuara me kontratë.                                            |
| 5. | Subvencionet dhe transferet          | Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr hapa në përmbushjen e kërkesave ligjore për vitet e ardhshme, të përgatitet Plani Vjetor për Mbështetjes Financiare 30 ditë pas miratimit të Buxhetit, Raporti Gjithëpërfshirës Vjetor i mbështetje financiare publike për OJQ, si dhe të dhënat që përfshihen në plan të korrespondojnë me Buxhetin e Miratuar. |
| 6. | Investimet kapitale                  | Kryetari duhet të sigurojë se plani dinamik për përfundimin e punëve është respektuar nga OE, si dhe siguria e ekzekutimit do të mbetet valide për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës në mënyrë që t'i ikë rrezikut për shpenzimet shtesë në rast të vonesave në punë dhe dëmeve tjera.                                      |
| 7. | Llogaritë e arkëtueshme              | Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke intensifikuar bashkëpunimin me AKP-n lidhur me obligimet për NSH-të të cilat janë në menaxhimin e tyre, e po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga lejet afariste.                                           |

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Zukë Zuka, Udhëheqës i Auditimit



Sabile Muli, Udhëheqëse e ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



Fisnik Rudaj, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

|                                                                                                                                                      |                                             |                            |                                         |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|----------------------------|-----------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO<br>ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT<br>NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE |                                             |                            |                                         |
| DOKUMENTI I DOKUMENTIT<br>DOKUMENTI I DOKUMENTIT                                                                                                     |                                             |                            |                                         |
| Nr. Org.<br>Org. Unit.                                                                                                                               | Shit. Klasif.<br>Klasif. Kod<br>Class. Code | Nr. Prot.<br>Nr. Prot. No. | Nr. Faqeve<br>Nr. Stranica<br>No. Pages |
| 04                                                                                                                                                   | 47                                          | 929                        | 1                                       |



Komuna e Lipjanit

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyren e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Lipjanit, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti").
- pajtohem/nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe (kjo pikë përshatet nga entiteti)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Imri Ahmeti

Kryetar i Komunes së Lipjanit

Data: 18/06/2021



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>7</sup> Ky opinion duhet të veçohet nga opinionin nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

## Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

## Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtureshmëria me autoritetet - pajtureshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtureshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtureshmëria me autoritetet: pajtureshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.